GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Buletini Informativ

Janar — Qershor 2021

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS 2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....5

AKTGJYKIME 8

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME 13

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

** Pas përfundimit të mandatit të Kryetares së Gjykatës Kushtetuese dhe dorëheqjes të një gjyqtari në muajin qershor, Gjykata aktualisht përbëhet nga 7 (shtatë) gjyqtarë.*

Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 janar – 30 qershor 2021, Gjykata ka pranuar 120 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 306 kërkesa/lëndë. Gjithsej 155 kërkesa janë zgjidhur ose 50.65% e të gjitha rasteve në disponim.

Gjatë kësaj periudhe, 130 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

Dinamika e kërkesave të pranuara sipas muajve (1 janar – 30 qershor 2021)



Në vijim janë paraqitur 20 aktgjykimet që Gjykata nxori gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 janar – 30 qershor 2020:

- Aktgjykim në rastin KI 207/19, parashtruar nga: NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve [A.A.U.ZH.nr.20/2019], të datës 30 tetor 2019 dhe [A.A.U.ZH.nr.21/2019], të datës 5 nëntor 2019] të Gjykatës Supreme të Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KO 95/20, parashtruar nga: Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës [nr. 07/V-014], të datës 3 qershor 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KI 230/19, parashtruar nga: Albert Rakipi. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Pml. nr. 253/2019], të datës 30 shtator 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 160/19, KI 161/19, KI 162/19, KI 164/19, KI 165/19, KI 166/19, KI 167/19, KI 168/19, KI 169/19, KI 170/19, KI 171/19, KI 172/19, KI 173/19 dhe KI 178/19, parashtruar nga: Muhamet Këndusi dhe të tjerët. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës [AC-I-13-0181-A0008], të datës 29 gusht 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 181/19, KI 182/19 dhe KI 183/19, parashtruar nga: Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës [AC-I-13-0181-A0008], të datës 29 gusht 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 24/20, parashtruar nga: "Pamex" sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ae.nr.179/2017], të datës 11 nëntor 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 86/18, parashtruar nga: Slavica Đordević. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [CA.nr.2093/2017], të datës 29 janar 2018.
- Aktgjykim në rastin KI 45/20 dhe KI 46/20, parashtruar nga: Tinka Kurti dhe Drita Millaku. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës [AA.nr. 4/2020] dhe [AA.nr.3/2020], të datës 19 shkurt 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 220/19, KI 221/19, KI 223/19 dhe KI 234/19, parashtruar nga: Sadete Koca Lila dhe të tjerët. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, [AC-I-13-0181-A0008], të datës 29 gusht 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 177/19, parashtruar nga: N.N.T. "Sokoli". Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac.nr.2386/2018], të datës 17 maj 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 195/20, parashtruar nga: Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego". Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supremet ë Kosovës [ARJ-UZVP.nr. 42/2020], të datës 25 qershor 2020.

- Aktgjykim në rastin KI 20/21, parashtruar nga: Violeta Todorović. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, [nr. AC-I-16-0122], të datës 1 tetor 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 113/20, parashtruar nga: IF Skadeforsikring nga Norvegjia. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [E. Rev. nr. 62/2020], të datës 6 prill 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 186/19, KI 187/19, KI 200/19 dhe KI 208/19, parashtruar nga: Belkize Vula Shala dhe të tjerët. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, [AC-I-13-0181-A0008], të datës 29 gusht 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 195/19, parashtruar nga: Banka për Biznes. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ae.nr.287/18, të 27 majit 2019 dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 330/2019, të 1 gushtit 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 51/19, parashtruar nga: Qamil Lupçi. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, [A/02/68/2016] të datës 12 prill 2016.
- Aktgjykim në rastin KI 188/20, parashtruar nga: Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung". Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ae.nr.63/2019], të datës 15 tetor 2020.
- Aktgjykim në rastin KI 111/19, parashtruar nga: Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung". Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [E. Rev. nr. 1/2019], të datës 27 shkurt 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 235/19, parashtruar nga: Kompania e Sigurimeve "Allianz Suisse Versicherungs - Gesellschaft AG". Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [E. Rev. nr. 32/2019], të datës 31 korrik 2019.
- Aktgjykim në rastin KI 74/19, parashtruar nga: Kompania e Sigurimeve "SUVA Rechstabteillung". Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [E. Rev. nr. 39/2018], të datës 8 janar 2019.

Llojet e shkeljeve të pretenduara

Shkeljet e pretenduara, sipas llojit të shkeljeve (1 janar – 30 qershor 2021)



Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 120 kërkesat e pranuara gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 janar – 30 qershor 2021, janë si në vijim:

- Neni 7 [Vlerat], 2 raste ose 1,7%;
- Neni 21 [Parimet e përgjithshme], 4 raste ose 3,3%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] 4 raste ose 3.3%;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 30 raste ose 25 %;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 50 raste ose 41,7 %;
- Neni 32 [E drejta për mjete juridike], 2 raste ose 2,2%;
- Neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 3 raste ose 2,5%;
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 8 raste ose 6,7%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 4 raste ose 3,3%;

- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 1 rast ose 0,8%;
- Neni 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], 1 rast ose 0,8%;
- Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve], 1 rast ose 0,8%;
- Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], 1 rast ose 0,8%;
- Shkelje të tjera, 9 raste ose 7,5%;

Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 104 kërkesa ose 86,7% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 16 kërkesa ose 13,3% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 janar – 30 qershor 2021)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 janar – 30 qershor 2021, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 16 seanca plenare dhe 138 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime.

Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 130 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 20 Aktgjykime (10,3%);
- 92 Aktvendime për papranueshmëri (75,6%);
- 16 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (10,3%);
- 2 Vendime për ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës (1,5 %);

Struktura e vendimeve të publikuara
(1 janar – 30 qershor 2021)



Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 89 kërkesa nga shqiptarët, ose 74,2%;
- 6 kërkesa nga komuniteti serb, ose 5%;
- 5 kërkesa nga komunitetet e tjera, ose 4,2%;
- 20 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet e tjera publike (personat juridik) ose 16,7%;

Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave
(1 janar – 30 qershor 2021)



4 shkurt 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Nicholas Abbott.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetarja Rama-Hajrizi e njoftoi ambasadorin Abbott me punën e deritanishme të Gjykatës, me sfidat e përballura në punën e këtij institucioni në kushte pandemie, si dhe me përkushtimin e gjyqtarëve dhe të zyrtarëve të tjerë për shqyrtimin e kërkesave të parashtruara brenda afateve optimale.

Kryetarja Rama-Hajrizi shprehu mirënjohjen e saj për përkrahjen e vazhdueshme që Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar i ka ofruar ndër vite Gjykatës Kushtetuese, por edhe institucioneve të tjera shtetërore të Republikës së Kosovës, duke pasur në fokus primar respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e sundimit të ligjit dhe zhvillimin ekonomik në vend.

Ambasadori Abbott konfirmoi gatishmërinë e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për fuqizimin e mëtejmë të partneritetit ndërmjet dy vendeve në fushat me interes reciprok.

29 prill 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim njohës ambasadoren e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, znj. Carin Lobbezoo.

Puna e Gjykatës në kushte pandemie, sfidat në vendimmarrje dhe përkushtimi për zgjidhjen e lëndëve gjyqësore, ishin vetëm disa ndër temat që u diskutuan në takimin e përbashkët. Në vijim të bisedës, të dyja palët shkëmbyen pikëpamjet e tyre rreth zhvillimeve të fundit në lëmin e drejtësisë kushtetuese, si dhe rreth përpjekjeve të vazhdueshme që po bëhen nga institucionet e vendit për konsolidimin e shtetit të së drejtës, forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe rritjen e transparencës në sistemin e drejtësisë.

Kryetarja Rama – Hajrizi shprehu mirënjohjen e saj për ndihmën e ofruar ndër vite nga qeveria holandeze, në financimin e projekteve të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese.

Ambasadorja Lobbezoo u zotua se Holanda do të vazhdojë përkrahjen për Kosovën edhe në të ardhmen dhe theksoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve veçanërisht në fushën e rendit dhe ligjit.

25 maj 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Tomas Szunyog, në vazhdën e takimeve përshëndetëse me udhëheqës institucional vendor dhe ndërkombëtar në prag të përfundimit të mandatit të saj si gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetarja Rama-Hajrizi e njoftoi z. Szunyog me punën e deritanishme të Gjykatës, me sfidat e përballura nga gjyqtarët në shqyrtimin e lëndëve në kushte pandemie dhe vendimmarrjen në distancë, si dhe me përpjekjet e vazhdueshme që janë bërë për rritjen e cilësisë së vendimeve në përputhje me praktikat ndërkombëtare të drejtësisë kushtetuese.

Kryetarja Rama – Hajrizi në vijim të takimit shprehu mirënjohjen e saj për ndihmën e ofruar ndër vite nga institucionet evropiane në ngritjen e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese dhe shprehu

besimin që kjo ndihmë nuk do të mungojë as në të ardhmen.

Pasi që e falënderoi për mikpritjen, z. Szunyog e përgëzoi kryetaren Rama – Hajrizi për të arriturat e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për konsolidimin e praktikës gjyqësore të saj dhe për avancimin e gjyqësisë kushtetuese në vend në harmoni me standardet evropiane.

Z. Szunyog konfirmoi gatishmërinë e Zyrës së BE-së për të vazhduar përkrahjen për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, si dhe për institucionet e tjera në vend, në shërbim të forcimit të sundimit të ligjit.

28 maj 2021

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i prirë nga kryetarja e kësaj gjykate, znj. Vitore Tusha, qëndroi për vizitë zyrtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Delegacioni nga Shqipëria u prit në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama – Hajrizi dhe gjyqtarët e tjerë të Gjykatës, ku temë qendrore e diskutimit ishin funksionimi i të dy gjykatave në kushte pandemie, praktikat dhe metodat e punës në procedimin e lëndëve, vendimmarrja në distancë, si dhe konsolidimi i jurisprudencës të të dy gjykatave në harmoni me standardet ndërkombëtare të drejtësisë kushtetuese.

Në vijim të takimit, gjyqtarët e të dyja palëve diskutuan për përvojat dhe sfidat e deritanishme në trajtimin e çështjeve të ndryshme kushtetuese, për kontrollin incidental dhe atë abstrakt, si dhe për nivelin e zbatueshmërisë së aktgjykimeve në nivel vendi. Kryetarja Rama – Hajrizi dhe kryetarja Tusha në fund shprehën zotimin dhe gatishmërinë për intensifikimin e raporteve të bashkëpunimit ndërmjet dy gjykatave kushtetuese nëpërmjet organizimit të takimeve të rregullta vjetore dhe organizmit të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të shkëmbimit të ndërsjellë të përvojave.

25 qershor 2021

Me një ceremoni zyrtare të mbajtur në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës u bë pranim-dorëzimi solemn i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ndërmjet kryetares së deritanishme, znj. Arta Rama – Hajrizi dhe kryetares së zgjedhur, znj. Gresa Caka – Nimani.

Në fjalimin e saj përshëndetës, znj. Rama – Hajrizi foli për sfidat e përballura dhe të arriturat e Gjykatës Kushtetuese gjatë dy mandateve në krye të këtij institucioni, me ç'rast përveç gjyqtarëve falënderoi edhe të gjithë stafin e Gjykatës për bashkëpunimin dhe për punën e tyre të palodhur, duke theksuar se, "vetëm me përkushtimin dhe punën e përbashkët Gjykata arriti të kaloj me sukses të gjitha sfidat, duke filluar me tranzicionin nga përbërja e përzier ndërkombëtare në atë vendore, përmirësimin e dukshëm të kualitetit të vendimeve dhe arsyetimeve të shkruara, rritjen e integritetit dhe respektit të publikut ndaj Gjykatës, dhe çka është më e rëndësishmja, konsolidimin e rolit burimor të Gjykatës, e që është mbrojtja e frymës së Kushtetutës, e sistemit kushtetues dhe e të drejtave dhe lirive të secilit qytetar të Republikës së Kosovës". Tutje ajo rikujtoi se, "përmes vendimeve që kemi marrë jemi vlerësuar si një prej gjykatave më të mira në rajon dhe, si rrjedhojë, kemi arritur të forcojmë bashkëpunimin me gjykatat e tjera, partneritetin me Komisionin e Venecias, bashkëpunimin me Këshillin e Evropës dhe së fundi edhe me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

Në fund, znj. Rama-Hajrizi shprehu bindjen se nën udhëheqjen e kryetares Caka–Nimani, Gjykata Kushtetuese e Kosovës do të shënojë suksese të reja në të ardhmen dhe do të konsolidojë edhe më tej praktikën e saj gjyqësore në harmoni me standardet evropiane të drejtësisë kushtetuese.

Pas pranimit ceremonial të detyrës, kryetarja Caka-Nimani nënvizoi rëndësinë e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese dhe rolit të saj përcaktues në ruajtjen e rendit e kushtetues dhe vlerave kushtetuese, balancimin dhe ndarjen e pushteteve, avancimin e sundimit të ligjit e rendit demokratik, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ajo gjithashtu vuri theks edhe në nderin dhe përgjegjësinë e saj, që në bashkëpunim me të gjithë gjyqtarët e Gjykatës dhe stafin mbështetës, të kontribuojë në konsolidimin dhe avancimin e mëtejmë të drejtësisë kushtetuese në Republikën e Kosovës. Duke folur në emër të të gjithë gjyqtarëve dhe zyrtarëve të Gjykatës, kryetarja Caka-Nimani e falënderoi znj. Rama-Hajrizi për përkushtimin dhe punën e palodhur gjatë mandatit të saj si gjyqtare dhe kryetare e Gjykatës Kushtetuese për dy mandate, në rritjen e standardeve të gjykimit dhe të cilësisë së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për kontributin e jashtëzakonshëm të saj në mbrojtjen e pavarësisë institucionale të Gjykatës.

30 qershor 2021

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, pas marrjes së detyrës së Kryetares së Gjykatës, u takua me Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani – Sadriu.

Roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese si autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe rëndësia e saj në mbrojtjen e rendit dhe vlerave kushtetuese, forcimi i sundimit të ligjit dhe thellimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për garantimin e respektimit të kushtetutshmërisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ishin disa prej temave që u diskutuan në takimin e përbashkët të zhvilluar në Zyrën e Presidentes.

Në vijim të bisedës, të dyja palët shkëmbyen pikëpamjet e tyre edhe sa i përket nevojës për ruajtjen dhe përforcimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe avancimit të mekanizmave për mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët e Kosovës në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Aktgjykim

KO 95/20

Parashtrues

Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kërkesa bazohej në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 , si dhe në rregullin 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin, parashtruesit e kërkesës pretenduan se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve], të Kushtetutës.

Përfundime

Me datat 28 mars dhe 20 gusht 2019, Etem Arifi ishte dënuar me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, me një vit e tre muaj burgim. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Etem Arifi kandidoi dhe u zgjodh deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatin e zgjedhjeve dhe në listën e deputetëve të certifikuar ishte edhe Etem Arifi. Më 26 dhjetor 2019, u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit ku u konfirmua mandati i Etem Arifit. Që nga ajo kohë, Etem Arifi vazhdoi të ushtronte funksionin e deputetit, edhe pse ndaj tij rëndonte një dënim gjyqësor i formës së prerë, për një vepër penale, me një vit e tre muaj burgim.

Në këtë kërkesë kushtetuese, 17 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestuan kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, për zgjedhjen e Qeverisë, të nxjerrë me 3 qershor 2020. Parashtruesit pretendojnë se Vendimi në fjalë është në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës. Kjo sepse, sipas parashtruesve, në procedurën e votimit të Vendimit të kontestuar ka marrë pjesë edhe Etem Arifi, vota e të cilit ishte e pavlefshme për shkak të dënimit të tij me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Gjykata vlerësoi se, çështja themelore që ngërthen kjo kërkesë është se a kishte pasur mandat të vlefshëm Etem Arifi në kohën e nxjerrjes në Kuvend të Vendimit të kontestuar për zgjedhjen e Qeverisë (në votimin e të cilit ai kishte marrë pjesë).

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata mori parasysh: përgjigjet e dorëzuara nga shtetet anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, qëndrimet e Komisionit të Venecias; si dhe praktikën e mëhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për situata të ngjashme.

Për sa i përket dispozitave kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës, që i japin përgjigje çështjeve të ngritura nga kjo kërkesë, Gjykata gjeti se:

Neni 71.1 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcakton se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhjet për Kuvend nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit;

Neni3 (6) i Kushtetutës përcakton se mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse ai/ajo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, me një ose më shumë vite burgim. Ky përcaktim kushtetues përforcohet edhe me nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, nenin 112.1.a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 25.1.d të Rregullores së Kuvendit;

Gjykata konsideroi se, për sa i përket të drejtës për kandidim në zgjedhje parlamentare, nenet 45, 55 dhe 71.1 të Kushtetutës duhet lexuar në mënyrë të ndërlidhur. Kështu, neni 45 i Kushtetutës flet përgjithësisht për të drejtat zgjedhore, duke përcaktuar në mënyrë të përgjithësuar se ato mund të kufizohen me vendime gjyqësore kurse neni 55 përcakton kushtet kumulative në bazë të të cilave mund të kufizohen të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Ndërsa neni 71 i Kushtetutës – i cili flet ekskluzivisht për "kualifikimet" për të kandiduar për deputet të Kuvendit – përcakton se secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë vjeç

ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet. Këto "kriteret ligjore", të cilave iu referohet neni 71 i Kushtetutës, i përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili në nenin 29.1 (q) thekson qartë dhe shprehimisht se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhje për Kuvend, nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit. Ky përcaktim kushtetues dhe ligjor është në linjë edhe me praktikën që ndiqet nga shumë vende demokratike, siç vërehet edhe nga dokumentet përkatëse të Komisionit të Venecias, si dhe nga përgjigjet e vendeve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias.

Gjykata theksoi se, normat e mësipërme kushtetuese dhe ligjore, të cilat kanë të bëjnë me pamundësinë (papërshtatshmërinë) për t'u kandiduar për deputet në zgjedhjet e përgjithshme, si dhe me mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, si pasojë e dënimit me burgim për kryerjen e veprave penale, nuk duhen parë si qëllim në vetvete. Në thelb, këto norma nuk kanë synim parësor ndëshkimin e individëve të caktuar duke ua pamundësuar atyre ushtrimin e funksionit të deputetit, por kanë si qëllim themelor mbrojtjen e integritetit kushtetues dhe besueshmërisë qytetare në organin ligjdhënës, si shtyllë e demokracisë parlamentare.

Gjykata konsideroi se besueshmëria qytetare në Kuvendin e Republikës së Kosovës cenohet nëse – pavarësisht ndalesave që vë neni 71 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – lejohet që mandatin e deputetit ta fitojë dhe ta ushtrojë një person që është dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë të vlefshëm në Republikën e Kosovës.

Në lidhje me këtë, Gjykata solli në vëmendje Raportin e Komisionit të Venecias, i cili thekson se, "ligjshmëria është element i Sundimit të Ligjit dhe nënkupton që ligji duhet të respektohet nga individët dhe autoritetet. Ushtrimi i funksionit politik nga personat të cilët kanë shkelur ligjin në mënyrë serioze vendos në rrezik zbatimin e këtij parimit [sundimit të ligjit], që është njëri nga parakushtet e demokracisë, dhe për këtë arsye rrezikon natyrën demokratike të shtetit". (*Shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përjashtimin e Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, CDL-AD(2015)036, i 23 nëntorit 2018, paragrafi 168*).

Në këtë frymë, Gjykata vlerësoi se është kërkesë e qartë kushtetuese e mishëruar në nenin 71.1 në ndërlidhje me nenin 70.3 (6) të Kushtetutës, se është e papajtueshme me Kushtetutën që një person ta fitojë dhe ta mbajë mandatin e deputetit nëse është i dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë, siç është përcaktuar me këto dispozita. Kjo kërkesë përforcohet me nenet 29 dhe 112 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë Deputetit. Më tutje, Gjykata theksoi se fakti që neni 70.3 (6) i Kushtetutës, neni 8.1.6 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe neni 112.1 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i referohen dënimit të deputetit (pra dënimit pasi ai ta ketë fituar mandatin), është reflektim i prezumimit se neni 29.1 (q) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili mbështetet në nenin 71.1 të Kushtetutës, nuk lejon që një person i dënuar me burgim gjatë tri viteve të fundit para zgjedhjeve të kandidojë për deputet dhe të fitoj mandatin e deputetit.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në gjuhën e qartë të nenit 71.1 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nënparagrafit 6 të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata konsideroi se asnjë person nuk mund të fitojë dhe mbajë mandat të vlefshëm të deputetit nëse është i dënuar për vepër penale sikurse parashihet me këto dispozita, me vendim gjyqësor të formës së prerë, nëse kundër tij/saj ka një vendim dënues që është në fuqi në Republikën e Kosovës.

Gjykata vërejti sqarimin e KQZ-së se, sipas Aktgjykimit AA.-Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017 të Gjykatës Supreme, "askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje, nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që do të thotë, se kandidati duhet me vendim të formës së prerë, të shpallet fajtor dhe gjykata, t'i ketë shqiptuar dënimin plotësues "heqjen e të drejtës për tu zgjedhur".

Megjithatë, Gjykata konsideroi se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk kërkon që personave të dënuar për vepra penale t'iu shqiptohet medoemos si dënim plotësues "heqja e të drejtës për t'u zgjedhur", në mënyrë që ata të mos lejohen të kandidojnë në zgjedhje parlamentare. Kjo meqë, sipas nenit 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndër të tjera, parashihen edhe këto dy baza: (i) heqja e të drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje me vendim të PZAP-it dhe gjykatës; si dhe (ii) pamundësia për të qenë kandidat për shkak të shpalljes fajtor për një vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit. Këto janë baza të ndryshme/të ndara që shkaktojnë pamundësinë/papërshtatshmërinë për të qenë kandidat. Gjykata është e mendimit se ky interpretim përputhet edhe me leximin e ndërlidhur të neneve 45, 55 dhe 71 të Kushtetutës.

Gjykata e konsideroi të rëndësishme të vë në dukje se kandidimi në zgjedhje parlamentare i Etem Arifit, zgjedhja e tij si deputet dhe ushtrimi i mandatit të deputetit – të gjitha këto pasi që ai ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë – shpërfaqin ekzistimin e paqartësisë normative dhe të metave serioze në mekanizmat institucionalë të Republikës së Kosovës, që janë kompetent për të garantuar ligjshmërinë dhe integritetin kushtetues të proceseve zgjedhore dhe veprimtarisë parlamentare. Kjo paqartësi është e dukshme edhe në përgjigjet që janë dhënë nga trupat përkatës të Kuvendit dhe nga KQZ-ja.

Në lidhje me këtë, Gjykata potencoi nevojën që Kuvendi i Republikës së Kosovës me komisionet e tij, në bashkëveprim me institucionet gjegjëse, duke përfshirë edhe KGJK-në dhe KQZ-në, të qartësojnë

dhe konsolidojnë bashkëpunimin ndër-institucional dhe aspektet normative që kanë të bëjnë me kandidimin në zgjedhje parlamentare dhe ushtrimin e mandatit të deputetit, nga ana e personave të dënuar për vepra penale.
Kjo është e domosdoshme për të shmangur situatat paradoksale, nga këndvështrimi kushtetues, ku një person, pasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë sikurse parashihet me nenet përkatëse të Kushtetutës dhe ligjeve, i lejohet të kandidojë në zgjedhje parlamentare, të zgjidhet deputet, t'i verifikohet mandati, si dhe të vazhdojë të ushtrojë funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, madje edhe gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë që, Kushtetuta dhe ligjet përkatëse vënë barriera të qarta normative për të mos lejuar personat e dënuar me burgim për kryerjen e veprave penale, që të zgjedhën deputet dhe të ushtrojnë mandatin e deputetit.
Për sa i përket zgjedhjes së Qeverisë, Gjykata theksoi se në mënyrë që Qeveria të zgjidhet, konform paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, "për" Qeverinë duhet të votojnë të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë të Kuvendit. Në rastin konkret, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit, Gjykata vëren se më 3 qershor 2020, gjashtëdhjetë e një (61) deputetë kishin votuar "për" Qeverinë, gjegjësisht për vendimin e kontestuar. Për miratimin e Vendimit të kontestuar kishte votuar edhe Etem Arifi. Pasi Gjykata gjeti se mandati i Etem Arifit kishte qenë i pavlefshëm para votimit të Vendimit të kontestuar, ai Vendim kishte marrë vetëm gjashtëdhjetë (60) vota të vlefshme. Për pasojë, procedura për të zgjedhur Qeverinë nuk është zhvilluar në përputhje me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Gjykata vuri në pah se neni 95 i Kushtetutës, siç është interpretuar përmes praktikës së saj gjyqësore, parasheh dy tentativa për të zgjedhur Qeverinë nga Kuvendi. Në të dyja rastet, Qeveria për t'u konsideruar e zgjedhur duhet të këtë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) vota. Nëse as pas tentimit të dytë nuk zgjidhet Qeveria, neni 95.4 i Kushtetutës parasheh shpalljen e zgjedhjeve nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.
Gjykata rikujtoi që, Qeveria e votuar përmes Vendimit nr. 07/V-014 të Kuvendit, të 3 qershorit 2020, është bazuar në Dekretin e Presidentit nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020, të nxjerrë bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, përkatësisht në tentativën e dytë për zgjedhjen e Qeverisë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujtoi interpretimin e dhënë në Aktgjykimin KO72/20 ku kishte theksuar se "zgjedhjet do të jenë të pa evitueshme në rast të dështimit të zgjedhjes së Qeverisë edhe në tentativën e dytë, [...] me ç'rast, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, Presidenti shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre".
Në dritën e kësaj, Gjykata theksoi se në rastin konkret vihet në lëvizje paragrafi 4 i nenit 95 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.
Gjykata e konsideroi të rëndësishme të theksojë se është e vetëdijshme se Etem Arifi ka marrë pjesë edhe në procedura të tjera votuese në Kuvend, edhe pasi ai nuk kishte mandat të vlefshëm. Megjithatë, duke u mbështetur në parimin non ultra petita ("jo përtej kërkesës"), Gjykata u kufizua në vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar më kërkesën e paraqitur para saj, gjegjësisht Vendimit nr. 07/V-014, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
Gjykata e konsideroi të nevojshme që të sqarojë po ashtu se, duke u nisur nga parimi i sigurisë juridike, si dhe nga fakti se ky Aktgjykim nuk mund të ketë efekt prapaveprues, vendimet e Qeverisë aktuale mbeten në fuqi, si dhe Qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

Aktgjykim

KI 45/20 dhe KI 46/20

Parashtrues

Tinka Kurti dhe Drita Millaku

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA.nr. 4/2020, të 19 shkurtit 2020 dhe AA.nr.3/2020, të 19 shkurtit 2020

Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës [AA.nr. 4/2020], të datës 19 shkurt 2020 dhe [AA.nr.3/2020], të datës 19 shkurt 2020. Parashtrueset e kërkesës pretendonin se me vendimet e kontestuara u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 45 [Të drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe me nenin 3 (E Drejta për Zgjedhje

të Lira) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Kërkesa bazohej në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

Përfundime

Rastet e bashkuara KI 45/20 dhe KI 46/20 janë dy raste që kanë të bëjnë me kontestet rreth zgjedhjeve të 6 tetorit 2019. Kërkesat janë parashtruar nga dy kandidate (Tinka Kurti dhe Drita Millaku) për deputete nga subjekti politik i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (LVV) – të cilat pretendonin se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme kanë zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese mënyrën e zëvendësimit të deputetëve të përcaktuar me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.
Gjykata rikujtoi që disa deputetë të subjektit politik LVV, të cilët u zgjodhën në pozita qeveritare/ komunale, liruan disa pozita të deputetëve të cilat duhej të zëvendësoheshin me kandidatët e ligjshëm në radhë për deputetë. Kësisoj, nga deputetët të cilët liruan ulëset e tyre u bënë zëvendësimet vijuese: kandidati Enver Haliti me 7,777 vota zëvendësoi deputetin Albin Kurti; kandidati Alban Hyseni me 7,767 vota zëvendësoi deputetin Glauk Konjufca; kandidatja Arta Bajralia me 7,674 vota zëvendësoi deputeten Albulena Haxhiu; kandidati Fitim Haziri me 7,542 vota zëvendësoi deputetin Arben Vitia; kandidati Eman Rrahmani me 7,044 vota zëvendësoi deputetin Haki Abazi. Më vonë, kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota zëvendësoi deputetin Shpejtim Bulliqi.
Domosdoshmëria e zëvendësimit të deputetëve aktivizoi në mënyrë automatike dispozitat ligjore të përcaktuara me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – nen ky që specifikon mënyrën e zëvendësimit të deputetëve, me tekst vijues:
"112.2 Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin 112.1 zëvendësohet si vijon:
a) nga kandidati i ligjshëm në radhë i të njëjtës gjini i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të Subjektit Politik në emër të së cilës garoi anëtari; [...]"
Gjykata vërejti se, sipas interpretimit që këtij neni iu është bërë nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, të gjitha zëvendësimet ishin bërë bazuar në kriterin e "gjinisë" dhe pa marrë parasysh rezultatin e arritur nga kandidatët për deputetë pas plotësimit të kuotës obligative ligjore për përfaqësim prej 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë. Kësaj mënyre të zëvendësimit të paraparë me ligj, sipas Gjykatës Supreme, nuk kanë mundur t'i shmangen as KQZ, as PZAP e as Gjykata Supreme ngase ekziston supozimi se ligjet janë në pajtim me Kushtetutën dhe se ato duhet zbatuar ashtu siç janë, "deri sa nga Gjykata Kushtetuese të konstatohet se një ligj ose ndonjë dispozitë ligjore e tij është në kundërshtim me Kushtetutën".
Duke mos u pajtuar me këtë interpretim, parashtrueset e kërkesave dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese, nën pretendimin kyç se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme e kanë zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese mënyrën e zëvendësimit të deputetëve të paraparë me nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në thelb, ato pretenduan se përkundër plotësimit dhe tejkalimit të kuotës prej 30% nga kandidatet gra për deputete nga LVV – zëvendësimet për deputetë ishin bërë jo bazuar në rezultat zgjedhor por bazuar në gjini. Sipas tyre, kjo gjë ka shkaktuar pabarazi në trajtim dhe shkelje të së drejtës së tyre për t'u zgjedhur.
Gjykata rikujtoi që, bazuar në mënyrën e zëvendësimit të aplikuar nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, deputetët burra ishin zëvendësuar nga kandidatët burra për deputetë dhe deputetet gra ishin zëvendësuar nga kandidatet gra për deputete – përkundër faktit që parashtrueset e kërkesave kishin marrë më shumë vota se disa nga kandidatët burra që arritën të zgjedhën deputetë të Kuvendit. Parashtruesja e parë, Tinka Kurti kishte mbledhur 7655 vota dhe parashtruesja e dytë, Drita Millaku kishte mbledhur 7063.
Gjykata sqaroi se, nuk është duke vlerësuar in abstracto nëse neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është apo nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo për faktin që, as para kësaj Gjykate e as para institucioneve paraprake publike që e kanë trajtuar këtë çështje, parashtrueset asnjëherë nuk kanë pretenduar që neni në fjalë është kundërkushtetues. Përkundrazi, parashtrueset vetëm kanë pretenduar që ky nen është zbatuar në mënyrë kundërkushtetuese nga KQZ, PZAP e Gjykata Supreme.
Duke marrë për bazë faktet e mësipërme dhe pretendimet e ngritura në këtë rast, Gjykata në këtë ankesë individuale kushtetuese trajtoj faktin se: A është zbatuar neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga ana e KQZ-së, PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me garancitë, vlerat dhe parimet e proklamuara me nenet 24 dhe 45 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së?
Gjykata Kushtetuese konstatoi se, interpretimi i këtij neni nga ana e KQZ-së, PZAP-së dhe Gjykatës Supreme nuk është interpretim i saktë dhe kushtetues për disa nga arsyet vijuese – të cilat janë gjerësisht të shtjelluara në Aktgjykim.
Së pari, Gjykata konstatoi se KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, e kanë interpretuar nenin 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në mënyrë të ngurtë e tekstuale dhe të shkëputur nga të gjitha normat e tjera ligjore të parapara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Barazi Gjinore si dhe parimet, vlerat dhe frymën e shkronjës e Kushtetutës. Ky lloj interpretimi ka abstrahuar kontekstin, qëllimin dhe arsyen e vendosjes së kuotës prej 30%, si masë e veçantë për të ndihmuar drejt arritjes së përfaqësimit

të barabartë në mes të dy gjinive në Kuvendin e Republikës. Së dyti, Gjykata potencoi se *ratio legis* i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të përfaqësimit gjinor në Kuvend, konsiston në atë që siguron – në çdo rrethanë -përfaqësim prej të paktën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar ose gjinisë pakicë (cilado qoftë ajo). Mirëpo, qartazi, 30% paraqet vetëm kufirin minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, por jo edhe kufirin më të lartë të përfaqësimit të njërës gjini. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se, në momentin që sigurohet përfaqësimi minimal prej 30% për gjininë e nënpërfaqësuar, të gjitha zëvendësimet e ardhshme duhet të bëhen në bazë të renditjes të kandidatëve për deputetë, të cilën e përcakton rezultati zgjedhor. Mbi këtë bazë, kuota gjinore zbatohet vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin është vendosur, pra, për të siguruar përfaqësimin e detyrueshëm minimal të gjinisë pakicë në kuotën prej 30%, ndonëse ideali kushtetues dhe fryma e Kushtetutës, e reflektuar në nenin 7, synojnë arritjen e barazisë faktike 50% me 50% në mes të dy gjinive. Së treti, Gjykata theksoi se interpretimi i nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme sipas mënyrës së interpretimit nga KQZ, PZAP dhe Gjykata Supreme, do të kishte kuptim vetëm në situatën kur mund të ndodhë që mos-zëvendësimet gjini-për-gjini (grua-për -grua ose burrë-për-burrë) do të mund të rrezikonin mos-përmbushjen e kuotës ligjore prej 30% të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar. Mirëpo, interpretimi i këtij neni, në mënyrën siç është bërë, kur dihet se në zgjedhjet e 6 tetorit 2019 kandidatet gra të subjektit politik LVV kishin arritur të merrnin vota meritore përtej përqindjes së kuotës ligjore prej 30%, është interpretim i gabuar i kësaj norme dhe në shpërputhje me vet qëllimin e kuotave ligjore të përcaktuara me nenin 27 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Së katërti, Gjykata potencoi se qëllimi i vendosjes së kuotave ndërlidhet me nevojën për avancimin e barazisë gjinore brenda një shoqërie deri në arritjen e një barazie faktike, kur kuotat bëhen të panevojshme. Neni 112.2 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ekziston për një arsye të vetme: të paraqes mënyrën e zëvendësimit të deputetëve – gjithnjë duke ruajtur qëllimin e përfaqësimit obligativ ligjor prej të paktën 30% të gjinisë pakicë. Nëse pas plotësimit të normës prej 30%, kandidatët nga gjinia pakicë (të nënpërfaqësuar) arrijnë të bëhen deputetë me forcat e tyre vetanake duke korrur rezultat më të mirë se sa pjesëtarët e gjinisë shumicë, atyre nuk duhet t'u mohohet e drejta për t'u zgjedhur deputetë të Kuvendit. Gjykata konstatoi se, parashtruesja Tinka Kurti është diskriminuar në bazë të gjinisë në lidhje me të drejtën e saj për t'u zgjedhur, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% përmes rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në momentin kur u krijua mundësia e zëvendësimit të deputetëve, e njëjta edhe pse kishte më shumë vota se kandidatët burra për deputetë Fitim Haziri dhe Eman Rrahmani, nuk iu mundësua që të bëhej deputete. Më tutje, Gjykata gjithashtu konstatoi se, parashtruesja Drita Millaku është diskriminuar në bazë të gjinisë në lidhje me të drejtën e saj për t'u zgjedhur, në momentin kur edhe përkundër përmbushjes së kuotës minimale 30% nëpërmjet rezultatit zgjedhor në kuadër të subjektit politik LVV, në momentin kur u krijua mundësia për zëvendësimet e ardhshme të deputeteve, përkatësisht kur dha dorëheqje deputeti Shpejtim Bulliqi, në vend të tij, në bazë të përcaktimit për zëvendësim në kuadër të gjinisë së njëjtë, më 18 dhjetor 2020, mandat deputeti mori kandidati Taulant Kryeziu me 6968 vota.

Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi që: Aktvendimi [AA. nr. 4/2020] i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Aktvendimi [AA. nr. 3/2020] i 19 shkurtit 2020, i Gjykatës Supreme; Vendimi i PZAP [Anr. 35/2020] i 13 shkurtit 2020; Vendimi i PZAP [Anr. 36/2020] i 13 shkurtit 2020; si dhe pika 5 e Vendimit të KQZ [nr. 102/A-2020] i 7 shkurtit 2020, janë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 3 (E Drejta për Zgjedhje të Lira) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

Efekti i Aktgjykimit

Gjykata vërejti se, për arsye objektive dhe në interes të sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në lidhje me mandatet e deputetëve. Në këtë aspekt, Gjykata sqaroi se ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe që në bazë të parimit të sigurisë juridike nuk prek të drejtat e palëve të treta të fituara në bazë të vendimeve të anuluara me këtë Aktgjykim. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që ky Aktgjykim është thjesht deklarativ dhe pa asnjë efekt.

Efekti i parë i këtij Aktgjykimi është shfuqizimi i vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, PZAP-it dhe KQZ-së, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, në aspekt të interpretimit të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Përmes shfuqizimit të këtyre vendimeve, ky Aktgjykim sqaron për të ardhmen se, bazuar në një lexim të saktë dhe kontekstual të nenit 112.2 (a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zëvendësimi i kandidatëve për deputetë duhet të bëhet në atë mënyrë që: së pari, të sigurohet përfaqësimi minimal në masën 30% të gjinisë së nënpërfaqësuar (gjinisë pakicë), e cila nuk mund të vihet në pikëpyetje në asnjë moment; dhe së dyti, në rastet kur kuota gjinore prej 30% është përmbushur bazuar në rezultatin zgjedhor (siç ishte rasti konkret), atëherë zëvendësimet e kandidatëve për deputetë duhet të bëhen në bazë të rezultatit zgjedhor, pa u kufizuar në aspektin e zëvendësimit në bazë të gjinisë së njëjtë, përderisa nuk rrezikohet minimumi i përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar.

Efekti i dytë që ky Aktgjykim mundëson, ka të bëjë me të drejtën që iu lind parashtrueseve të kërkesave ose palëve të tjera që mund të preken nga ky Aktgjykim, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij të fundit. Këtyre palëve iu lind e drejta për shfrytëzimin e mjeteve të tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejmë të të drejtave në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të cituar në këtë Aktgjykim.

GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 janar – 30 qershor 2021)

* Kompensimi i dhënë ndaj një gazetari për postimin e disa artikujve në blogun e tij duke kritikuar një tjetër gazetar: Shkelje e lirisë së shprehjes (12/01/2021)

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Gheorghe-Florin Popescu kundër Rumanisë** (*kërkesa nr. 79671/13*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Çështja kishte të bënte me vendimin e autoriteteve vendore për të urdhëruar parashtruesin e kërkesës, një gazetar, të paguante dëmin për publikimin e pesë postimeve në blog që kritikonin L.B, një gazetar tjetër i cili ishte kryeredaktori i një gazete në grupin mediatik Desteptarea dhe producent për një kanal televiziv lokal që i përket të njëjtit grup. Gjykata konstatoi, në veçanti, se gjykatat vendore nuk kishin dhënë arsyet përkatëse dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e parashtruesit për lirinë e shprehjes. Standardet e zbatuara nga gjykatat e brendshme nuk ishin në përputhje me parimet e mishëruara në nenin 10 të Konventës, duke përfshirë, në veçanti, kontributin në një debat me interes publik, nëse personi në fjalë ishte i njohur dhe sjellja e tij ose e saj e mëparshme, përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit dhe ashpërsinë e sanksionit të vendosur. Ato as nuk i kishin bazuar vendimet e tyre në një vlerësim të pranueshëm të fakteve përkatëse. Rezultoi që ndërhyrja në të drejtën e parashtruesit për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike" dhe se kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

* Një urdhër që kërkon që ueb-faqja e Mediapart të heqë transkriptimet dhe kasetat e bisedave që ishin regjistruar në mënyrë të paligjshme në shtëpinë e znj. Bettencourt nuk e ka shkelur Konventën (14/01/2021)

Në aktgjykimin e saj të Dhomës në rastin **SociétéEditrice de Mediapart dhe të tjerët kundër Francës** (*kërkesat nr. 281/15 dhe nr. 34445/15*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, që nuk kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Të dy rastet kishin të bënin me një urdhër të lëshuar kundër Mediapart, një ueb-faqe lajmesh, redaktorit të saj botues dhe një gazetari për të hequr nga faqja e internetit të kompanisë së lajmeve ekstrakte audio dhe transkriptime të incizimeve të paligjshme të bëra në shtëpinë e znj. Bettencourt, aksionarja kryesore e grupit L'Oréal. Gjykata përsëriti që neni 10 i Konventës nuk garantonte një liri tërësisht të pakufizuar të shprehjes, madje edhe në lidhje me mbulimin nga media të çështjeve me interes serioz publik. Ushtrimi i kësaj lirie barte me vete "detyra dhe përgjegjësi", të cilat vlejnë edhe për shtypin. Parashtruesit e kërkesës kishin qenë të vetëdijshëm se zbulimi i incizimeve të bëra pa dijeninë e znj. Bettencourt ishte një shkelje, e cila duhej t'i kishte çuar ata të tregonin maturi dhe kujdes.
Gjykata përsëriti parimin se gazetarët nuk mund të pretendonin një imunitet ekskluziv nga përgjegjësia penale për të vetmen arsye se, ndryshe nga individët e tjerë që ushtronin të drejtën e lirisë së shprehjes, vepra në fjalë ishte kryer gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gazetare. Në rrethana të caktuara, edhe kur një person ishte i njohur për publikun e gjerë, ai ose ajo mund të mbështetet në një "pritje legjitime" të mbrojtjes dhe respektimit të jetës së tij/saj private. Kështu, fakti që një individ i përkiste kategorisë së figurave publike nuk mundet, veçanërisht në rastin e personave të cilët, si zonja Bettencourt, nuk ushtronin funksione zyrtare, të autorizojnë mediet të shkelin parimet profesionale dhe etike të cilat duhej të rregullonin veprimet e tyre, ose legjitimojnë ndërhyrjet në jetën private.
Gjykatat vendore kishin vendosur kundër parashtruesve të kërkesës për t'i dhënë fund shqetësimit të shkaktuar një gruaje e cila, megjithëse një figurë publike, kurrë nuk kishte dhënë pëlqimin për zbulimin e incizimeve dhe transkriptimeve në fjalë, ishte e pambrojtur dhe kishte një pritje legjitime për të hequr nga faqja e lajmeve publikimet e paligjshme - të cilat ajo kurrë nuk kishte qenë në gjendje t'i komentonte, për dallim nga opsioni që i ishte ofruar gjatë gjykimit penal .Gjykata nuk mund të shihte arsye të forta që kërkonin nga ajo të zëvendësonte pikëpamjen e saj me atë të gjykatave të brendshme dhe të linte mënjanë ushtrimin e balancimit të kryer nga to. Ajo ishte e bindur që arsyet në të cilat ishin mbështetur ishin të rëndësishme dhe të mjaftueshme për të treguar se ndërhyrja për të cilën ankohej ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike" dhe se urdhri në fjalë nuk kishte shkuar përtej asaj që ishte e nevojshme për të mbrojtur znj. Bettencourt dhe P.D.M. nga ndërhyrja në të drejtën e tyre për respektimin e jetës private.

* Refuzimi i autoriteteve për të njohur ligjërisht një ndryshim të identitetit gjinor në mungesë të një operacioni kishte shkelur Konventën (19/01/2021)

Në vendimin e Dhomës së saj në rastin **X dhe Y kundër Rumanisë** (*kërkesat nr. 2145/16 dhe 20607/16*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur**: shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.
Rasti kishte të bënte me situatën e dy personave transgjinorë, kërkesat e të cilëve për njohjen e identitetit të tyre gjinor dhe për korrigjimet përkatëse administrative që duhej bërë ishin refuzuar me arsyetimin se personat që bënin kërkesa të tilla duhej të paraqisnin prova se kishin kaluar ndërhyrje kirurgjikale për ndryshimin e gjinisë. Gjykata vërejti se

gjykatat kombëtare u kishin paraqitur parashtruesve të kërkesës, të cilët nuk dëshironin t'i nënshtroheshin operacionit të ndryshimit të gjinisë, një dilemë të pamundur: ose u duhej t'i nënshtroheshin operacionit kundër gjykimit të tyre më të mirë - dhe të hiqnin dorë nga ushtrimi i plotë i të drejtës së tyre për të respektuar integritetin fizik - ose iu desh të heqin dorë nga njohja e identitetit të tyre gjinor, i cili gjithashtu hyri brenda fushës së respektimit të jetës private. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo kishte prishur ekuilibrin e drejtë që duhet të vendoset nga Shtetet Palë midis interesit të përgjithshëm dhe interesave individualë të personave në fjalë. Gjykata vendosi që refuzimi i autoriteteve vendase për të njohur ligjërisht ndryshimin e gjinisë së parashtruesve të kërkesës në mungesë të operacionit ishte një ndërhyrje e pajustifikuar në të drejtën e tyre për respektimin e jetës së tyre private.

*** Dënimi i vendosur ndaj parashtruesit për kërkim lëmoshë në publik kishte shkelur Konventën (19/01/2021)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Lăcătuş kundër Zvicrës** (*kërkesa nr. 14065/15*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.
Rasti kishte të bënte me një urdhër që parashtruesi të paguante një gjobë prej 500 frangash zvicerane (CHF) (afërsisht 464 euro (EUR) për kërkim lëmoshë në publik në Gjenevë, dhe paraburgimi i saj në burg për pesë ditë për mospagim të gjobës. Gjykata vërejti se parashtruesi, i cili ishte analfabet dhe vinte nga një familje jashtëzakonisht e varfër, nuk kishte punë dhe nuk po merrte përfitime sociale. Kërkimi i lëmoshës përbënte një mjet mbijetese për të. Duke qenë në një situatë të pambrojtur, parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë, e natyrshme në dinjitetin njerëzor, të ishte në gjendje të përcillte gjendjen e saj të vështirë dhe të përpiqej të plotësonte nevojat e saj themelore duke kërkuar lëmoshë.
Gjykata vlerësoi se dënimi i vendosur ndaj parashtruesit nuk ishte proporcional as me qëllimin e luftimit të krimit të organizuar, as me atë të mbrojtjes së të drejtave të kalimtarëve, banorëve dhe tregtarëve. Gjykata nuk u pajtua me argumentin e Gjykatës Federale se masat më pak kufizuese nuk do të kishin arritur një rezultat të krahasueshëm. Sipas mendimit të Gjykatës, dënimi i vendosur kishte cenuar dinjitetin njerëzor të parashtruesit të kërkesës dhe kishte dëmtuar thelbin e të drejtave të mbrojtura me nenin 8 të Konventës, dhe shteti kishte tejkaluar lirinë e tij të vlerësimit në rastin në fjalë.

*** Refuzimi për të lejuar një të burgosur të konsultohet me faqet e internetit për çështje ligjore (siç është ajo e Gjykatës Evropiane) ishte i pajustifikuar (09/02/2021)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Ramazan Demir k. Turqisë** (*kërkesa nr. 68550/17*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes: liria për të marrë informata dhe ide)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me refuzimin e autoriteteve të burgut për të miratuar një kërkesë për qasje në faqet e caktuara të Internetit, të paraqitura nga z. Demir gjatë ndalimit të tij paraprak në Burgun e Silivri në vitin 2016.
Z. Demir, një avokat, dëshironte të kishte qasje në faqet e Internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, Gjykatës Kushtetuese dhe Gazetës Zyrtare, me qëllim të përgatitjes së mbrojtjes së tij dhe ndjekjen e rasteve të klientëve të tij. Gjykata konsideroi që meqenëse qasja e të burgosurve në disa faqe që përmbajnë informacion ligjor tashmë ishte miratuar sipas ligjit turk për qëllime trajnimi dhe rehabilitimi, kufizimi i qasjes së z. Demir në faqet e lartpërmendura, që përmbante vetëm informacione ligjore që mund të ishin në lidhje me zhvillimin dhe rehabilitimin e parashtruesit të kërkesës në kontekstin e profesionit dhe interesave të tij, përbënin ndërhyrje në të drejtën e tij për të marrë informata.
Në lidhje me këtë, ajo vlerësoi se gjykatat vendore nuk kishin dhënë shpjegime të mjaftueshme se pse qasja e z. Demir në faqet e Internetit të Gjykatës, Gjykatës Kushtetuese ose Gazetës Zyrtare nuk mund të konsiderohej se kishte të bënte me trajnimin dhe rehabilitimin e parashtruesit të kërkesës, për të cilat qasja e të burgosurve në Internet ishte e autorizuar me legjislacionin kombëtar, as nëse dhe pse z. Demir duhej të konsiderohej si i burgosur që paraqet një rrezik të caktuar ose i përket një organizate ilegale, në lidhje me të cilën mund të kufizohej qasja në Internet. Përveç kësaj, as autoritetet dhe as Qeveria nuk kishin shpjeguar pse masa e kontestuar ishte e nevojshme në rastin konkret, duke pasur parasysh qëllimet legjitime të ruajtjes së rendit dhe sigurisë në burg dhe parandalimin e krimit. Rezultoi që ndërhyrja në fjalë nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

*** Procedurat e vetingut që çuan në shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese ishin të drejta dhe proporcionale me shkarkimin (09/02/2021)**

Në vendimin e Dhomës së saj në rastin **Xhoxhaj kundër Shqipërisë** (*kërkesa nr. 15227/19*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vlerësoi se nuk kishte pasur: me shumicë 6 kundër 1, **shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut në lidhje me pretendimin e mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë së organeve të vetingut, me shumicë prej 5 me 2, nuk kishte shkelje të nenit 6 paragrafi 1 në lidhje me pretendimin për parregullsi të procedurave, me një shumicë prej 5 me 2, nuk kishte shkelje të nenit 6 paragrafi 1 në lidhje me pretendimin e mungesës së një dëgjimi publik para Kolegjit ë Apelit, me një shumicë prej 5 me 2, nuk kishte shkelje të nenit 6 paragrafi 1 në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike, dhe me shumicë prej 5 me 2 **nuk kishte shkelje të nenit 8 (e drejta për**

respektimin e jetës private dhe familjare). Rasti kishte të bënte me një gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese e cila ishte shkarkuar nga detyra pas rezultatit të procedurave të filluara në lidhje me të, si pjesë e një procesi të jashtëzakonshëm për rivlerësimin e përshtatshmërisë për zyrën e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend, i njohur ndryshe si procesi i vetingut. Çështja e parashtrueses u shqyrtua nga organet e vetingut dhe shkarkimi i saj u konfirmua jozyrtarisht nga Kolegji i Apelit.
Gjykata konstatoi në veçanti se, nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 pasi organet e vetingut kishin qenë të pavarura dhe të paanshme, procedurat kishin qenë të drejta, mbajtja e një dëgjimi publik para Kolegjit të Apelit nuk ishte kërkuar në mënyrë rigoroze dhe nuk ishte shkelur parimi i sigurisë juridike. Për më tepër, Gjykata vlerësoi se largimi nga detyra ishte proporcional dhe se ndalimi i përhershëm ligjor i vendosur ndaj parashtrueses për t'iu bashkuar sistemit të drejtësisë për shkak të shkeljeve të rënda etike kishte qenë në përputhje me sigurimin e integritetit të zyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, dhe kështu nuk kishte shkelur të drejtat e saj sipas nenit 8.

*** Gjykata sqaron kushtet për zbatimin e prezumimit të mbrojtjes ekuivalente në kontestet në lidhje me ekzekutimin e një urdhër-arresti evropian (25/03/2021)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Bivolaru dhe Moldovan kundër Francës** (*kërkesat nr. 40324/16 dhe 12623/17*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut **në kërkesën nr. 12623/17**, të paraqitur nga z. Moldovan, **dhe nuk ka pasur shkelje të nenit 3 në kërkesën nr. 40324/16**, të parashtruar nga z. Bivolaru. Rasti kishte të bënte me dorëzimin e parashtruesve nga Franca tek autoritetet rumune nën urdhër-arrestet evropiane (EAW) për qëllimin e ekzekutimit të dënimeve të tyre me burg. Rasti e shtyu Gjykatën të sqarojë kushtet për zbatimin e prezumimit të mbrojtjes ekuivalente në rrethana të tilla. Gjykata vendosi që prezumimi i mbrojtjes ekuivalente të zbatuar në tastin e z. Moldovan për aq sa ishin përmbushur dy kushtet për zbatimin e tij, përkatësisht mungesa e ndonjë margjine manovrimi nga ana e autoriteteve kombëtare dhe vendosja e potencialit të plotë të mekanizmit mbikëqyrës të paparë me ligjin e Bashkimit Evropian (BE). Prandaj, Gjykata u kufizua në konstatimin nëse mbrojtja e të drejtave të garantuara me Konventë kishte qenë në mënyrë të dukshme e mangët në rastin konkret, në mënyrë të tillë që ky supozim të kundërshtohej. Për këtë qëllim, ajo u përpoq të përcaktojë nëse kishte pasur një bazë faktike mjaft të fortë që i kërkonte autoritetit gjyqësor ekzekutues për të gjetur se ekzekutimi i EAW do të sillte një rrezik real dhe individual për parashtruesin e kërkesës për t'iu nënshtruar trajtimit në kundërshtim me nenin 3 për shkak të kushteve të tij të paraburgimit në Rumani. Gjykata vuri në dukje se z. Moldovan kishte siguruar prova të rrezikut të pretenduar që ishte vërtetuar mjaftueshëm për të kërkuar që autoriteti gjyqësor ekzekutues të kërkonte informacione dhe sigurime shtesë nga shteti lëshues në lidhje me kushtet e tij të ardhshme të paraburgimit në Rumani.
Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3 për aq sa dukej se autoritetet gjyqësore ekzekutuese, duke ushtruar kompetencat e tyre të diskrecionit, nuk kishin nxjerrë përfundimet e duhura nga informacioni i marrë, megjithëse ai informacion kishte siguruar një bazë faktike mjaft të fortë për të refuzuar ekzekutimin e EAW në fjalë.
Në rastin e z. Bivolaru, Gjykata konsideroi se, për shkak të vendimit të saj për të mos kërkuar një vendim paraprak nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE) mbi implikimet për ekzekutimin e një EAW të dhënies së statusit të refugjatit nga një shtet anëtar për një shtetas të një vendi të tretë, i cili më pas gjithashtu u bë një shtet anëtar, Gjykata e Kasacionit kishte vendosur pa vendosjen e potencialit të plotë të makinerisë përkatëse ndërkombëtare për mbikëqyrjen e të drejtave themelore. Prezumimi i mbrojtjes ekuivalente nuk ishte i zbatueshëm. Kishte dy aspekte të ankesës së z. Bivolaru: i pari në lidhje me implikimet e statusit të tij të refugjatit dhe i dyti në lidhje me kushtet e paraburgimit në Rumani. Nuk kishte asgjë në dosje përpara autoritetit gjyqësor ekzekutues ose prova të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës para Gjykatës për të sugjeruar se ai do të përballej ende me një rrezik persekutimi për arsye fetare në Rumani në rast të dorëzimit të tij.
Gjykata vlerësoi se autoriteti gjyqësor ekzekutues, pas një ekzaminimi të plotë dhe të thellë të situatës individuale të parashtruesit të kërkesës, që demonstroi se kishte marrë parasysh statusin e tij të refugjatit, nuk kishte pasur një bazë faktike mjaft të fortë për të vërtetuar ekzistencën e një rreziku real për shkeljen e nenit 3 të Konventës dhe për të refuzuar ekzekutimin e EAW për atë arsye. Gjykata gjithashtu konsideroi se përshkrimi i kushteve të paraburgimit në burgjet rumune të ofruara nga parashtruesi për autoritetin gjyqësor ekzekutues në mbështetje të kërkesës së tij për mos ekzekutimin e EAW nuk ishte detajuar ose vërtetuar mjaftueshëm sa të përbënte prova prima facie të një rreziku real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3 në rast të dorëzimit të tij tek autoritetet rumune. Sipas mendimit të Gjykatës, autoriteti gjyqësor ekzekutues nuk ishte i detyruar të kërkonte informata shtesë nga autoritetet rumune. Prandaj, ajo vendosi që nuk kishte pasur një bazë të fortë faktike për autoritetin gjyqësor ekzekutues për të vërtetuar ekzistencën e një rreziku real të shkeljes së nenit 3 të Konventës dhe për të refuzuar ekzekutimin e EAW për ato arsye.

*** Ndalimi i shpërndarjes së informacionit mbi një hetim mbi pretendimet për korrupsion: Shkelja e lirisë së shprehjes së një gazetari (04/05/2021)**

Aktgjykimi i Dhomës së saj në rastin Akdeniz **dhe të tjerët kundër Turqisë** (*kërkesat nr. 41139/15 dhe 41146/15*) kishte të bënte me një urdhër të përkohshëm të urdhëruar nga gjykatat vendase që ndalon shpërndarjen dhe publikimin (në cilindo medium) të informacionit për një hetim parlamentar për pretendimet e korrupsionit kundër katër ish-ministrave, i cili ishte nxitur pas një operacioni të kryer nga policia dhe zyra e prokurorit të Stambollit më 17 dhe 25 dhjetor 2013.
Parashtruesit e kërkesës, Banu Güven (një gazetar i njohur), si dhe Yaman Akdeniz dhe Kerem Altıparmak (dy akademikë që janë përdorues të njohur të platformave të medieve sociale) kërkuan heqjen e ndalimit në fjalë, duke u mbështetur në të drejtën e tyre për liri për të dhënë informacion dhe ide, si dhe të drejtën e tyre për të marrë informacion. Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën e tyre për shkak të mungesës së statusit të viktimës, pasi ata nuk ishin prekur drejtpërdrejt ose personalisht nga urdhri. Gjykata theksoi se në vetvete, një masë që konsiston në ndalimin e publikimit të mundshëm dhe shpërndarjes së informacionit nga çdo medium ngriti një çështje të lirisë së informacionit.
Ajo njëzëri e deklaroi kërkesën e Banu Güven të pranueshme në lidhje me ankesën sipas nenit 10 (liria e shprehjes). Ajo pranoi që znj. Güven, një gazetare, komentuese politike dhe prezantuese e lajmeve TV në kohën materiale, mund të pretendonte në mënyrë legjitime se ndalimi i kontestuar kishte cenuar të drejtën e saj për lirinë e shprehjes. Prandaj, ajo mund të kërkojë statusin e viktimës.
Në lidhje me këtë, Gjykata theksoi se nuk duhet të neglizhohet se mbledhja e informacionit, e cila ishte e natyrshme në lirinë e shtypit, u konsiderua gjithashtu si një parakusht i rëndësishëm për të vepruar si gazetar; dhe se, në kontekstin e debatit për një çështje me interes publik, ajo masë mund të pengonte gazetarët të kontribuonin në diskutimet publike të çështjeve të rëndësishme për jetën e komunitetit. Gjykata në vijim vendosi njëzëri se kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) e Konventës në lidhje me Banu Güven.
Në të vërtetë, urdhri i kontestuar, i cili kishte arritur në një masë parandaluese që synonte të ndalonte çdo shpërndarje ose publikim të informacionit në të ardhmen, kishte pasoja të mëdha në ushtrimin e së drejtës së parashtruesit për lirinë e shprehjes për një çështje aktuale. Një ndërhyrje e tillë nuk kishte një "bazë ligjore" për qëllimet e nenit 10, dhe për këtë arsye e kishte parandaluar znj. Güven të gëzonte një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes siç kërkohet me sundimin e ligjit në një shoqëri demokratike.
Në fund, Gjykata vendosi që z. Akdeniz dhe z. Altıparmak nuk kishin demonstruar se si ndalimi i kontestuar i kishte prekur ata drejtpërdrejt. Prandaj, ata nuk kishin statusin e viktimës në rastin në fjalë. Prandaj, Gjykata, me shumicë, deklaroi kërkesën e tyre të papranueshme.

* Pamundësia e parashtruesit për të shqyrtuar një ndalim të largimit nga vendi derisa një borxh të ishte shlyer plotësisht ishte në kundërshtim me Konventën (11/05/2021)

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Stetsov kundër Ukrainës** (*kërkesa nr. 5170/15*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 4 (liria e lëvizjes)** së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Çështja kishte të bënte me një ndalim të largimit nga vendi i vendosur ndaj z. Stetsov për shkak të dështimit të rimbursimit të një borxhi të vendosur me një aktgjykim. Sipas ligjit vendas në kohën materiale, ai ndalim nuk mund të hiqej derisa shuma e plotë e borxhit të paguhej. Ndalimi kishte zgjatur për të paktën katër vjet. Për sa i përket kufizimeve të vendosura në bazë të borxheve të papaguara, Gjykata theksoi se masa të tilla mund të justifikohen vetëm nëse ato ndjekin qëllimin për të garantuar rimbursimin e borxheve në fjalë. Prandaj, autoritetet nuk mund të zgjasnin kufizimet për kohë të gjatë pa një rishikim periodik të justifikimit të tyre.
Në rastin konkret, Gjykata konsideroi se z. Stetsov u ishte nënshtruar masave të cilat ishin arsyetuar në mënyrë të pamjaftueshme dhe nuk mund të rishikoheshin ose shqyrtoheshin deri në afatin e saktë të konstituuar nga data e rimbursimit të plotë. Prandaj, autoritetet ukrainase nuk kishin respektuar detyrimin për të siguruar që çdo ndërhyrje në të drejtën e një personi për të lënë vendin e tij ishte e justifikuar dhe proporcionale krahasuar me rrethanat, që nga fillimi dhe për sa kohë zgjaste ndërhyrja. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje reformën e viteve 2017 dhe 2018 të procedurës civile, e cila lejoi debitorët të parashtrojnë procedura për heqjen e kufizimeve të udhëtimit. Megjithatë, ajo reformë kishte hyrë në fuqi pas ngjarjeve që i kishin dhënë shkas kërkesës së z. Stetsov.

* Bllokimi i urdhëruar nga autoritetet për të trajtuar pandeminë COVID-19 të mos barazohet me arrest shtëpiak (20/05/2021)

Në vendimin e saj në rastin **Terheş kundër Rumanisë** (*kërkesa nr. 49933/20*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut njëzëri e **deklaroi kërkesën të papranueshme**. Rasti kishte të bënte me bllokimin i cili ishte urdhëruar nga qeveria rumune nga 24 marsi deri më 14 maj 2020 për të trajtuar pandeminë COVID-19 dhe që solli kufizime në largimin nga shtëpia të dikujt.
Gjykata vendosi se masa për të cilën ankohej nuk mund të barazohej me arrestin shtëpiak. Niveli i kufizimeve në lirinë e lëvizjes së parashtruesit të kërkesës nuk kishte qenë i tillë që bllokimi i përgjithshëm i urdhëruar nga autoritetet mund të konsiderohej se përbën një heqje të lirisë. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, për parashtruesin e kërkesës nuk mund të thuhej se ishte privuar nga liria e tij brenda kuptimit të nenit 5 paragrafi 1 të Konventës.

*** Shkarkimi i një punonjësi të sektorit publik për shkak të "pëlqimit" të postimeve në Facebook: Shkelje e së drejtës së saj për lirinë e shprehjes (15/06/2021)**

Në vendimin e Dhomës së saj në rastin **Melike kundër Turqisë** (*kërkesa nr. 35786/19*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Rasti kishte të bënte me shkarkimin e znj. Melike, një punonjës me kontratë në Ministrinë e Arsimit Kombëtar, për klikimin "Pëlqej" në artikuj të ndryshëm në Facebook (postuar në faqen e rrjeteve sociale nga një palë e tretë). Autoritetet konsideruan se kishte të ngjarë se postet në fjalë të prishnin paqen dhe qetësinë në vendin e punës, me arsyetimin se ata pretendonin se mësuesit kishin kryer përdhunime, përmbanin akuza kundër udhëheqësve politikë dhe kishin lidhje me partitë politike.
Gjykata vuri në dukje se, përmbajtja në fjalë përbëhej nga kritika politike virulente të praktikave të pretenduara shtypëse nga autoritetet, thirrje dhe inkurajim për të demonstruar në protestë kundër atyre praktikave, shprehje të indinjatës në lidhje me vrasjen e kryetarit të një shoqate avokatësh, denoncimet e abuzimit të pretenduar të nxënësve në institucionet e kontrolluara nga autoritetet dhe një reagim i mprehtë ndaj një deklarate, të perceptuar si seksiste, të bërë nga një figurë e njohur fetare. Gjykata vendosi që këto ishin çështje thelbësisht dhe pa dyshim me interes të përgjithshëm. Ajo përsëriti që kishte pak hapësirë në bazë të nenit 10 paragrafi 2 të Konventës për kufizimet në lirinë e shprehjes në dy fusha: fjalën politike dhe çështjet me interes publik.
Ajo gjithashtu vuri në dukje se komisioni disiplinor dhe gjykatat kombëtare nuk kishin marrë parasysh të gjitha faktet dhe faktorët përkatës për të arritur në përfundimin e tyre se veprimet e parashtruesit ishin të tilla që prishnin paqen dhe qetësinë në vendin e saj të punës. Veçanërisht, autoritetet kombëtare nuk kishin kërkuar të vlerësonin potencialin e "pëlqimeve" përkatëse për të shkaktuar një reagim negativ në vendin e punës të znj. Melike, duke pasur parasysh përmbajtjen e materialit me të cilin ato lidheshin, kontekstin profesional dhe shoqëror në të cilin ishin bërë dhe qëllimin dhe ndikimin e tyre të mundshëm. Prandaj, arsyet e dhëna në rastin konkret për të justifikuar shkarkimin e parashtrueses nuk mund të konsiderohen si relevante dhe të mjaftueshme. Gjykata gjithashtu vendosi që dënimi i vendosur për znj. Melike (ndërprerja e menjëhershme e kontratës së saj të punës pa të drejtë për kompensim) kishte qenë jashtëzakonisht i ashpër, veçanërisht për shkak të përvojës së gjatë të parashtrueses në pozitën e saj dhe moshës së saj. Në fund, ajo arriti në përfundimin se, duke pasur parasysh dështimin e tyre për të siguruar arsye përkatëse dhe të mjaftueshme për të justifikuar masën e kundërshtuar, gjykatat kombëtare nuk kishin zbatuar standarde që ishin në përputhje me parimet e parashikuara në nenin 10 të Konventës. Në çdo rast, nuk kishte pasur ndonjë marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis ndërhyrjes në të drejtën e znj. Melike për lirinë e shprehjes dhe qëllimit legjitim të ndjekur nga autoritetet kombëtare.

*** Shkarkimi nga detyra e një deputeti dhe diskualifikimi nga pozita si një kandidat elektoral për shkak të një dënimi penal: Kërkesa e papranueshme (17/06/2021)**

Në vendimin e saj në rastin **Galan kundër Italisë** (*kërkesa nr. 63772/16*) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut ka **shpallur njëzëri kërkesën të papranueshme**.
Rasti kishte të bënte me konfiskimin e vendit elektoral të parashtruesit të kërkesës si anëtar i parlamentit për shkak të një konstatimi nga Parlamenti që kishte një bazë të papranueshmërisë pas një dënimi për korrupsion.
Gjykata i kushtoi rëndësi qasjes së ndjekur nga Gjykata Kushtetuese Italiane, e cila kishte vendosur në praktikën e saj gjyqësore që diskualifikimi nga zgjedhja ose heqja nga detyra nuk ishin as ndëshkime dhe as efekte të dënimit penal. Përfaqësuesit e zgjedhur që u hoqën nga detyra e tyre u përjashtuan nga organi i zgjedhur në të cilin ata bënin pjesë sepse kishin humbur aftësinë e tyre morale, një kusht thelbësor për të vazhduar të përfaqësonin zgjedhësit. Gjykata konsideroi se diskualifikimi i kontestuar nga pozita si kandidat në zgjedhje dhe largimi nga detyra nuk mund të konsiderohej si ekuivalent i një dënimi penal brenda kuptimit të nenit 7 të Konventës. Kjo ankesë ishte e papajtueshme me dispozitat e Konventës dhe për këtë arsye duhej të refuzohej. Gjykata konsideroi se zbatimi i menjëhershëm i diskualifikimit nga pozita e kandidatit elektoral ishte në përputhje me qëllimin e deklaruar të legjislaturës, përkatësisht përjashtimin e personave të dënuar për vepra të rënda nga Parlamenti dhe kështu për të mbrojtur integritetin e procesit demokratik. Ky diskualifikim nga pozita si kandidat në zgjedhje nuk mund të konsiderohet si arbitrar ose joproporcional. Në fund, duke pasur parasysh garancitë e vendosura përmes procedurës parlamentare të "vlefshmërisë së trefishtë" - Komisioni i Përhershëm për papajtueshmëri, diskualifikime dhe heqje, Bordi i Zgjedhjeve dhe Dhoma e Deputetëve - Gjykata konsideroi se Konventa nuk kërkoi shqyrtim gjyqësor të një vendimi të miratuar nga Parlamenti në kontekstin e kompetencave të rezervuara kushtetuese.

(*Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int*)

INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen "Pejton". Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuara në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.
Objekti i Gjykatës ka gjithsej 784 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.

ADRESA

Rruga: "Perandori Justinian", nr. 44, 10 000 - Prishtinë
Tel: +383 (0)38 60 61 62
Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576
Fax: +383 (0)38 60 61 70
E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org
Ueb: www.gjk-ks.org